




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dop. Dep.	DPKI
Nr. lfaq Braj stranica Nr. pagas	03
Nr. Prot. Bij prot. Prot No	06-1830/20
Date Datum Date	08.09.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.09.2020, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPK-06-1188/20*, për zyrtarin e lartë z. Sadik Haxhiu, Dekan i Fakultetit Juridik, në Universitetin publik të Gjilanit “Kadri Zeka”, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli *AKK-DPK-06-1188/20*, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Sadik Haxhiu, Dekan i Fakultetit Juridik, në Universitetin publik të Gjilanit “Kadri Zeka”, është zhvilluar procedura e paraparë për trajtimin e situatave të konfliktit të Interesit.

Ky rast ka filluar të trajtohet, sipas detyrës zyrtare pas kontrollit ku është identifikuar se zyrtari i lartë publik, respektivisht Dekani i Fakultetit Juridik në Universitetin publik të Gjilanit “Kadri Zeka” figuron të jetë Kryetar dhe Person i autorizuar në Organizatën Joqeveritare “Shoqata Rëndësia e Votës”.

Sipas procedurës Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Departamenti për OJQ, në Ministrinë e Administratës Publike, që të bëjë verifikimin dhe konfirmimin e informacioneve dhe nga përgjigja zyrtare (shkresa zyrtare nr. *DPKI-06-776/20*), rezulton se zyrtari i lartë z. Sadik Haxhiu, është Kryetar dhe Person i autorizuar në Organizatën Joqeveritare “Shoqata Rëndësia e Votës” .

Pas konfirmimit të informacionit nga ana e Departamenti për OJQ, në Ministrinë e Administratës Publike, në pajtim me nenin 22, paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit nr.06/L-011, Agjencia përmes shkresës zyrtare, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Sadik Haxhiu, Dekan i Fakultetit Juridik, në Universitetin publik të Gjilanit “Kadri Zeka” për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të Interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese zyrtari i lartë z Sadik Haxhiu, ka treguar interesim duke kontaktuar zyrtaret e AKK-së, të cilët sipas procedurës e kanë informuar atë për inicimin e rastit dhe për obligimet ligjore të cilat i ka zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik, duke e njoftuar se zyrtari lartë nuk mundet që njëkohësisht të ushtrij funksion drejtues dhe as të jetë Përfaqësues i Autorizuar në Organizata Joqeveritare, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, siç e përcaktohet me nenin 13 paragrafi 1, të Ligjit nr.06/L-011, ku thuhet se :

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”,

si dhe nenin paragrafi 1, i cili përcakton se :

“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to”.

Pas kësaj procedure të quajtur ndryshe edhe si ballafaqim i fakteve, zyrtari i lartë z. Sadik Haxhiu, është pajtuar me gjetjet dhe faktet e Agjencisë, dhe do të ndërmer veprime të menjëhershme në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrim të funksionit publik.

Në ndërkohë, Agjencia ka pranuar njoftimin, informacionin zyrtar nga sistemi i Departamentit për OJQ-, me të cilën dëshmohet se z. Sadik Haxhiu, ka dhen dorëheqje nga funksioni i Kryetarit dhe Personit të autorizuar në Organizatën Joqeveritare “Shoqata Rëndësia e Votës.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Sadik Haxhiu, Dekan i Fakultetit Juridik, në Universitetin publik të Gjilanit “Kadri Zeka”, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e papajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik përkatësisht konfliktit të interesit, andaj, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

